



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1545/1 Prot

Tiranë, më 30.10.2019

V E N D I M

Nr.104, datë 30.10.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Shijak, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit”, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil në këtë bashki.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Shijak,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në shërbimin civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019 “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Shijak.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Shijak, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me vendimin nr. 68, dt. 20.12.2018, të Këshillit të Bashkisë Shijak “Për miratimin e buxhetit të bashkisë”, i ndryshuar dhe urdhrin nr. 65, datë 19.9.2019 të Kryetarit të Bashkisë Shijak “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Shijak”, strukturë e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Shijak së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **73** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **4** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **11** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **58** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se, **67** pozicione pune të shërbimit civil, janë plotësuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; **2** pozicione të shërbimit civil, rezulton se aktualisht janë plotësuar me punonjës të punësuar me akt emërimi apo kontrata të përkohshme, dhe jo sipas një procedure konkurrimi të hapur, e cila është e vetmja mënyrë për të plotësuar pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, për pozicionet e nivelit drejtues; ndërsa **4** pozicione të shërbimit civil rezultuan të lira.

Konkretisht, rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin evidentohen si më poshtë, ku specifikohet pozicioni i punës dhe punonjësi që kryen aktualisht detyrën, si edhe akti i emërimit i nxjerrë nga titullari i institucionit:

1. *****, në pozicionin “*Specialist i Teknologjisë dhe Informacionit*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, emëruar me kontratë pune datë 8.7.2019 (ky punonjës është emëruar fillimisht me akt emërimi nr. 3520 prot., datë 4.10.2018; kontratë pune datë 5.10.2018; kontratë pune datë 7.1.2019).
2. *****, me aktin nr. 14, datë 26.05.2015, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike*”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike, me ngritje në detyrë pa u zbatuar procedurat e kërkuara nga ligji.

Komisioneri konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.

Vërejmë se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç'ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii) të shkronjës "a" dhe shkronjës "ç", të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Shijak, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe në bazë të pikës 1, të nenit 111, të po këtij ligji, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t'u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV "*Pranimi në shërbim civil*", të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave "*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*" dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*", si dhe udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike "*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*".

Gjatë verifikimit të ligjshmërisë në institucion është evidentuar edhe rasti i punonjësës ***** , "*Specialiste në Sektorin e Auditimit të Brendshëm*", e cila është emëruar në këtë pozicion pune në kundërshtim me ligjin.

Në këtë përfundim arrijmë duke vlerësuar faktin se, në këtë rast nuk janë zbatuar kërkesat e posaçme të kërkuara nga ligji për këtë pozicion pune.

Konkretisht rezulton se, në momentin e shpalljes të lirë të pozicionit “*Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm*”, është vendosur si kriter arsimor paisja me diplomë e nivelit “*Bachelor*”, ndërkohë që ligji nr. 114/2015 “*Për auditin e brendshëm në sektorin publik*”, neni 11, pika 2/a, përcakton shprehimisht: “*Për punonjësit që punësohen në njësinë e auditimit të brendshëm, kërkohet të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet*”. Në rastin që po analizojmë konstatohet se në momentin që ka konkurruar, punonjësjë nuk ishte pajisur me diplomën përkatëse, por zotëronte diplomë “*Bachelor*”, në degën Financë.

Për më tepër, evidentohet fakti se, kjo punonjëse nuk zotëron as certifikatë auditi, kriter i kërkuar në pikën 2/ç, të nenit 11, të ligjit nr. 114/2015 “*Për auditin e brendshëm në sektorin publik*”. Kjo dispozitë parashikon edhe rregullimin e pasojave nëse nuk plotësohet kriteri si më sipër, duke përcaktuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës në këtë rast.

Mangësitë e lejuara në momentin e emërimit të punonjëses *****, që kanë të bëjnë me mosrespektimin e kërkesave ligjore të parashikuara nga ligji i posaçëm material të çojnë në përfundimin se akti administrativ, që ka shërbyer për lidhjen e marrëdhënies së punës në këtë rast, është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, çka parashikohet prej pikës “*d*”, të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”.

Në përfundim të analizës së mësipërme rezulton se, marrëdhënia e punësimit të punonjëses *****, e filluar nëpërmjet aktit të emërimit nr. 140, datë 2.07.2019 “*Për emërim në detyrë*”, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Auditimit të Brendshëm*”, në Bashkinë Shijak, është një veprim juridik i kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit material dhe si i tillë, bazuar në nenin 113/1, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*” duhet të shfuqizohet.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “*Procedura hetimore*”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Shijak, të konstatojë menjëherë, si akte administrative absolutisht të pavlefshëm, 2 rastet e emërimit të punonjësve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, që janë:
 - ✓ ***** , në pozicionin e punës “*Specialist i Teknologjisë dhe Informacionit*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, emëruar me kontratë pune datë 8.7.2019.
 - ✓ ***** , në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike*”, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike, emëruar me akt emërimi nr. 14, datë 26.05.2015.
2. Njësia përgjegjëse, të njoftojë ndërprerjen e marrëdhënies së punës të punonjësës ***** , në pozicionin e punës “*Specialiste e Auditimit të Brendshëm*”.
3. Njësia përgjegjëse, të shpallë menjëherë për t’u plotësuar pozicionet e shërbimit civil që, në kuptim të ligjit, janë vende vakante, si dhe ato të plotësuara në kundërshtim me ligjin në përputhje edhe me strukturën e institucionit në momentin e ekzekutimit të vendimit paralajmërues të Komisionerit dhe më tej, të vijojë realizimi i procedurave të konkurrimit.
4. Institucioni të përgatitë dhe të miratojë planin e nevojave për rekrutimin në shërbimin civil për vitin e ardhshëm, për pozicionet e mbetura vakant deri në shkurt të vitit 2020, duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr. 108, datë 26.2.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil*”.
5. Të përmbyllet procesi i mbikëqyrjes, i cili është materializuar me vendimin paralajmërues nr. 10, datë 26.1.2016, të Komisionerit “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Shijak*” dhe të vijojë rregullimi i situatës ligjore në këtë subjekt sipas dispozitivit të vendimit paralajmërues për këtë institucion.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i inspektuar dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në pjesën arsyetuese të tij. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, njësia e vetëqeverisjes vendore Bashkia Shijak, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.

7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Shijak, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Shijak, Ministria e Brendshme, si dhe çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin dhe që është i evidentuar në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha